

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“SHPRESA SECURITY SYSTEMS” – shpk

FORMIMI

Sot, më datë 19/09/2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë) në Tiranë formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “SHPRESA SECURITY SYSTEMS” – shpk e ortakut të saj themelues:

Besnik Palushi, atësia Gjon, i datëlindjes 07/11/1975, lindur në Fierzë, Tropojë e banues në Tiranë, rruga “Gjergj Legisi”, njësia bashkiake nr. 11, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal H51107031M.

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “SHPRESA SECURITY SYSTEMS” – shpk është në adresën: rruga “Asim Vokshi”, Nr. 140, kati i parë, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të hapë filiale, degë apo agjensi të tjera si brenda ashtu dhe jashtështetit shqiptar.

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është pa afat.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “SHPRESA SECURITY SYSTEMS” – shpk është:

“Import-eksport, tregtim me shumicë e me pakicë, instalimi dhe shërbimi i produkteve të sistemeve të sigurisë. Tregtimi, transportimin e mallrave dhe instalimin e mjeteve të sistemit vrojtues, sinjalizues, audioviziv, mjeteve të mbrojtjes kundra zjarrit, pajisjeve të ndërlihdjes, të teknikave të tjera të lejuara nga legjislacioni; si dhe projektimin, instalimin dhe programimin e pajisjeve të telekomunikacionit, radio komunikacionit dhe sistemeve të kontrollit dhe monitorimit në distance të automjeteve me GPS; si dhe tregtimin dhe instalimin e mjeteve të mbrojtjes kundra zjarrit.

Ofrime rrjetesh dhe shërbimesh të komunikimeve elektronike. Ndërtim i linjave me fibra optike. Punime elektrike, ndertime per nenstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjise. Impiante të sinjalistikes ndricuese të trafikut, impiante, linja telefonike dhe komunikacioni, impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, Tv, etj; punime mekanike. Produkte dhe sisteme mbrojtje per perdorim personal dhe furnizim kompanish.

KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar i shoqërise tregtare “**SHPRESA SECURITY SYSTEMS**” – shpk është 200.000 lekë i përbërë nga 1 kuotë, që zotërohet nga ortaku i vetëm.
2. Ortaku i vetëm **Besnik Palushi** zotëron 1 kuote të vetme në shoqëri, e cila përfaqeson dhe ka vleren e 100% te vlerës së kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para prej 200.000 leke.
4. Kontributi në para do të shlyhet në llogarine bankare të shoqërisë nga ortaku i vetëm pas regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
5. Kapitali themeltar mund të shtohet ose të zvogëlohet me vendim të Ortakut të vetëm duke respektuar kërkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

ORGANET E SHOQERISE, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

1. Organi drejtues i shoqërisë dhe përfaqesues i saj do të jetë : Administratori
2. Administrator i “**SHPRESA SECURITY SYSTEMS**” - shpk do të jetë **z. Kastriot Vukaj**, i datëlindjes 15/10/1992, mbajtes i leternjoftimit ID me nr.personal J21015068K, i cila do të kryejë këtë funksion për një periudhë 5-vjeçare, ripërtëritshëm;
3. Organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë “**SHPRESA SECURITY SYSTEMS**” Sh.p.k. është Ortakut i vetëm i saj.
4. Vendimet e ortakut te vetem te shoqerise regjistrohen ne regjistrin e vendimeve te shoqerise.

DISPOZITA TË FUNDIT

Ky akt-themelimi hartohet në 3 (tre) kopje me vlerë të njëjtë, një kopje për Ortakun e vetëm, një në QKB, dhe një në selinë e shoqërisë.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

z. Besnik Palushi

2
